

Raporti për azilin, 2024

Përmbledhje ekzekutive



Raporti për azilin, 2024

Raporti vjetor për gjendjen e azilit në Bashkimin Evropian

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qershor 2024



© Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), 2024

As Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), as ndonjë person që vepron në emër të EUAA-së nuk janë përgjegjës për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban ky botim.

Fotografia e ballinës: iStock/[Halfpoint](#)

Luksemburg: Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, 2024

PDF BZ-AH-24-001-SQ-N ISBN 978-92-9403-956-9 ISSN 2600-3139 doi: 10.2847/037566

Ribotimi autorizohet vetëm nëse citohet burimi. Për përdorimin ose riprodhimin e fotografive ose të materialeve të tjera për të cilat EUAA-ja nuk ka të drejta autori, duhet të merret leja drejtpërdrejt te zotëruesi i këtyre të drejtave.

Parathënie

Për herë të parë që nga themelimi i Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS), Evropës iu kërkua të ndihmojë një numër të paprecedentë individësh që kërkonin mbrojtje. Në vitin 2023, kërkesat për azil u rritën në nivele që të kujtojnë krizën e refugjatëve të periudhës 2015-2016. Por në realitet, shtetet ofruan mbrojtje për shumë më tepër njerëz, pasi u regjistruan mbi 4,3 milionë përfitues të mbrojtjes së përkohshme që prej nisjes së pushtimit rus, krahas mbi 1,1 milionë azilkërkuesve në 2023.

Në këtë situatë, miratimi i Paktit të Ri për Migracionin dhe Azilin përbënte një moment të rëndësishëm për BE-në në avancimin e sistemit të saj unik të azilit shumëkombësh. Ky sukses u katalizua në sajë të vullnetit politik, fleksibilitetit dhe përpjekjeve gjithëpërfshirëse në nivel teknik për të sheshuar detajet specifike të një kuadri të sofistikuar. Pakti do të luajë një rol thelbësor në konvergimin e praktikave dhe do t'u mundësojë vendeve të BE+ të adresojnë numrin e lartë të azilkërkuesve.



Por, le të theksojmë se shtetet anëtare do të duhet të vazhdojnë të tregojnë këmbëngulje në vitet e ardhshme. Mbetet ende punë për t'u bërë në adresimin e prapambetjeve ekzistuese, në përpunimin në mënyrë efektive të numrit të shtuar të kërkesave në hyrje dhe në sigurimin e akomodimit për aplikuesit për mbrojtje. Njëkohësisht, autoritetet do të duhet të ristrukturojnë sistemet e tyre të azilit dhe pritjes me qëllim harmonizimin me procedurat e përbashkëta të përcaktuara në pakt. Është e qartë se kjo do të kërkojë burime shtesë dhe plane të detajuara zbatimi në nivel kombëtar.

Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUA), operimi aktual i së cilës bazohet mbi një mandat të zgjatur për 2 vite, ka vazhduar të jetë një aktor kryesor në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare në Evropë, duke ofruar nivele të paprecedenta të mbështetjes operacionale, teknike dhe trajnuese në vitin 2023. Teksa hyjmë në një epokë të zhvillimeve të rëndësishme në sistemin e Evropës për azilin, një përgatitje e mirë do t'i mundësojë EUA-së të vazhdojë të ndihmojë në harmonizimin e praktikave në shtetet anëtare, duke shtuar ekspertizën dhe duke përmirësuar kapacitetin e Evropës për të ofruar zgjidhje lidhur me mbrojtjen.

Nina Gregori
Drejtoresh Ekzekutive
Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin



Përmbajtja

Përmbajtja	5
Hyrje.....	6
1. Zhvillimet globale në fushën e azilit në vitin 2023.....	7
2. Zhvillimet kryesore në fushën e azilit në Bashkimin Evropian në vitin 2023	8
3. Funksionimi i Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit.....	9
Rubrika 1. Mbrojtja e përkohshme për personat e zhvendosur nga Ukraina	9
3.1. Aksesimi në procedurë.....	10
3.2. Procedura e Dublinit.....	12
3.3. Procedurat e veçanta për vlerësimin e nevojave për mbrojtje	13
3.4. Përpunimi i kërkesave për azil në shkallë të parë.....	14
3.5. Përpunimi i kërkesave për azil në shkallë të dytë ose në shkallët më të larta.....	16
3.6. Pritja e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare	16
3.7. Aspektet e ndalimit që përfshijnë azilkërkuesit dhe ish-azilkërkuesit	17
3.8. Aksesimi në informacion	18
3.9. Asistenca dhe përfaqësimi ligjor	18
3.10. Shërbimet e përkthimit	19
3.11. Informacioni për vendin e origjinës.....	19
3.12. Mungesa e shtetësisë në kontekstin e azilit.....	20
3.13. Përmbajtja e mbrojtjes	20
3.14. Risistemimi dhe pranimet për motive humanitare.....	22
4. Fëmijët dhe personat me nevoja të veçanta në procedurën e azilit.....	23
5. Mbështetja e EUAA-së në vitin 2023	25
Vërejtjet përfundimtare	27




Hyrje

Përmbledhja ekzekutive e [Raportit për azilin, 2024: Raporti vjetor për gjendjen e azilit në Bashkimin Evropian](#) përmbledh zhvillimet kryesore lidhur me mbrojtjen ndërkombëtare, të cilat paraqiten në detaje në raportin kryesor.


Përmbledhja është në dispozicion në [30 gjuhë](#), duke përfshirë të gjitha gjuhët e BE-së, si dhe në shqip, arabisht, maqedonisht, rusisht, serbisht, turqisht dhe ukrainisht.

Informacioni që paraqitet në raportin kryesor mund të filtrohet përmes burimeve të ndryshme, praktike për përdoruesit:


- [Baza e të dhënave e zhvillimeve kombëtare për azilin](#) paraqet zhvillimet legjislative, institucionale dhe të politikave, të cilat përshkruhen në raport. Përditësimet mund të kërkohen sipas vendit, temës, vitit dhe llojit të zhvillimit. Informacioni gjithashtu përmbledhet dhe paraqitet në një tabelë, sipas vendit dhe sipas fushës tematike, në një dokument PDF.
- Raporti paraqet një përzgjedhje të zhvillimeve jurisprudenciale bazuar në [Bazën e të dhënave të jurisprudencës së EUAA-së](#). Hiperlink-et brenda tekstit do t'i drejtojnë lexuesit te rasti specifik në bazën e të dhënave.
- Burimet e përdorura për përgatitjen e raportit për azilin gjenden në listën e referencave në fund të raportit. Ato janë gjithashtu të disponueshme në një dokument të veçantë e të detajuar [Burimet për azilin, 2024](#), të grupuara sipas llojit të burimit. Lexuesit mund të identifikojnë lehtësisht nëse burimet janë nga institucionet dhe agjencitë evropiane, organizatat ndërkombëtare, autoritetet kombëtare, organizatat e shoqërisë civile ose grupet e ekspertëve dhe academia.



Additional resources to the Asylum Report 2024



Translations
in all EU
languages
and 7 non-EU
languages





1. Zhvillimet globale në fushën e azilit në vitin 2023



Nevojat për mbrojtje vazhduan të rriteshin në vitin 2023, ndërkohë që asnjë zhvillim i vetëm nuk shërbeu si katalizator në të njëjtën mënyrë si pushtimi rus i Ukrainës, marrja e pushtetit në Afganistan nga talebanët ose pandemia COVID-19 vitet e mëparshme. Megjithatë, këto kriza vazhduan të ndikojnë te zhvillimet në vitin 2023 mes konflikteve të reja dhe të vazhdueshme, tronditjeve klimatike, trazirave gjeopolitike, dhunës dhe persekutimit që sollën largimin e miliona njerëzve nga shtëpitë e tyre.

Numri i personave të zhvendosur me forcë gjatë vitit 2023 arriti një pik historik prej mbi 114 milionë, ku vendet më problematike përfshinin Afganistanin, Republikën Demokratike të Kongos, vendet e Amerikës Latine dhe Karaibeve, Mianmarin, Somalinë, Sudanin dhe Ukrainën. Përshkallëzimi i konfliktit në Gaza nga tetori 2023 e në vazhdim dhe kriza humanitare që e pasoi rritën në mënyrë drastike nevojat për mbrojtje në rajon.

Në këtë situatë, komuniteti ndërkombëtar vazhdoi përpjekjet për zhvillimin e zgjidhjeve për njerëzit në nevojë për mbrojtje, shpesh përmes bashkëpunimit shumëpalësh dhe një diversiteti në rritje të aktorëve të përfshirë në ofrimin e zgjidhjeve. Një nga shembujt kryesorë të një nisme të tillë ishte angazhimi në Forumin e dytë Global për Refugjatët në dhjetor 2023. Qeveritë, aktorët ndërkombëtarë, sektori privat dhe organizatat e shoqërisë civile kontribuan me mbi 2,2 miliardë USD për politika dhe programe specifike në mbështetje të popullsisë të zhvendosura dhe vendeve që strehojnë refugjatë, si dhe u zotuan të risistemojnë 1 milion refugjatë deri në vitin 2030 dhe të ndihmojnë 3 milionë individë të tjerë përmes programit të sponsorizimit komunitar.

Ndryshimi klimatik dhe roli i tij kontribuues në zhvendosje, si dhe ndikimi i tij te refugjatët dhe komunitetet pritëse, vazhduan të jenë ndër temat kryesore në diskursin në lidhje me mbrojtjen ndërkombëtare. Diskutimet prekën gjithashtu çështjen e mungesës së shtetësisë në kontekstin e azilit, si dhe ndërveprimin midis mungesës së shtetësisë dhe nevojave për mbrojtje.

Teksa komuniteti ndërkombëtar vazhdon të adresojë aspekte komplekse të modeleve në ndryshim të vazhdueshëm të zhvendosjes, një ndërgjegjësim që sa vjen e konsolidohet duket se informon diskursin dhe praktikën e mbrojtjes ndërkombëtare në harkun kohor të viteve të fundit: zhvendosja e detyruar nuk përbën vetëm një shqetësim humanitar, por edhe një sfidë për zhvillimin. Pjesa më e madhe e refugjatëve në mbarë botën jo vetëm që vijnë nga zona problematike, por arratisen gjithashtu drejt zonave po të tilla, ku mbi tre të katërtat e individëve të zhvendosur në nivel global strehohen në vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Qasja humanitarizëm-zhvillim-paqe e spikatur në përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar gjatë viteve të fundit, advokon për reagime gjithëpërfshirëse nga grupet e ndryshme të interesit, duke përfshirë bizneset, institucionet financiare dhe organizatat e shoqërisë civile, për të përdorur ekspertizën e tyre përkatëse në arritjen e zgjidhjeve zhvillimore.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-1-global-developments-field-asylum-2023>



2. Zhvillimet kryesore në fushën e azilit në Bashkimin Evropian në vitin 2023



Parlamenti Evropian dhe Këshilli arritën një marrëveshje politike në dhjetor 2023 për instrumentet kryesore legjislative të Paktit për Migracionin dhe Azilin. Një gjë e tillë përbënte një zhvillim të konsiderueshëm në reformën e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS), që i hapte rrugën finalizimit të instrumenteve për të pajisur Evropën me një strukturë funksionale dhe moderne të migracionit dhe azilit.

Në vitin 2023, BE vazhdoi të ndërmarrë masa për adresimin e pasojave shkatërruese të agresionit rus ndaj Ukrainës, duke përfshirë hapa për katalizimin e bashkëpunimit më të ngushtë midis aktorëve ndërkombëtarë dhe duke prezantuar instrumente për të mbështetur rimëkëmbjen, rindërtimin dhe modernizimin e Ukrainës. Zgjatja e mbrojtjes së përkohshme deri në mars 2025 ofroi stabilitet dhe parashikueshmëri për miliona përfitues. Duke riafirmuar angazhimin afatgjatë evropian për paqen, sigurinë dhe prosperitetin në rajon, në dhjetor 2023, Këshilli Evropian vendosi të hapë negociatat e pranimit me Ukrainën, pas një rekomandimi nga Komisioni Evropian.

Presioni në kufijtë e jashtëm të BE-së vazhdoi, me numrin më të lartë të kalimeve të parregullta kufitare që nga viti 2016. Sipas të dhënave paraprake të mbledhura nga Frontex, 385 000 kalime të parregullta kufitare u zbuluan në kufirin e jashtëm të BE-së, çka përbën një rritje prej 18% krahasuar me vitin 2022. Për të adresuar këtë problematikë, BE prezantoi nisma për menaxhimin efektiv të kufijve të saj të jashtëm duke përgatitur një strategji evropiane të menaxhimit të integruar të kufijve, duke përmirësuar sistemet ekzistuese të informacionit dhe ndërveprimin e tyre, si dhe duke bashkëpunuar me vendet partnere kyç në të gjitha rrugët e emigracionit.

Për të plotësuar dy planet e veprimit të vitit 2022 në lidhje me rrugët e Mesdheut Qendror dhe Ballkanit Perëndimor, Komisioni Evropian paraqiti dy plane veprimi shtesë në vitin 2023 për të adresuar rrugët e Mesdheut Perëndimor, Atlantikut dhe Mesdheut Lindor. Duke pranuar se rreth 90% e njerëzve që kalojnë kufijtë e jashtëm të BE-së e bëjnë këtë në mënyrë të parregullt me ndihmën e kontrabandistëve të emigrantëve, në nëntor 2023 Komisioni Evropian paraqiti propozime të reja legjislative për të parandaluar dhe luftuar kontrabandën e emigrantëve.

Për të promovuar zgjidhje të orientuara drejt mbrojtjes në mbarë botën, BE-ja vazhdoi bashkëpunimin e saj gjithëpërfshirës dhe me përfitime reciproke me vendet e treta. Aktivitetet në kuadër të dimensionit të jashtëm të politikës së BE-së për migracionin dhe azilin përfshinin përpjekje për të adresuar shkaqet rrënjësore të emigracionit të parregullt; për të zhvilluar rrugë ligjore për mbrojtjen në Evropë; për të ofruar mbështetje për zgjidhje lidhur me mbrojtjen në pjesë të tjera të botës; për të luftuar rrejetet kontrabanduese; dhe për të bashkëpunuar me vendet partnere për migracionin dhe menaxhimin e kufijve.

Në kuadër të rolit të saj për të siguruar një interpretim dhe zbatim të harmonizuar të legjislacionit të BE-së, në vitin 2023, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GjDBE) lëshoi më shumë se [20 vendime dhe urdhra](#) që interpretojnë dispozita të ndryshme të CEAS, për



shembull që mbulojnë tema që lidhen me aksesin në procedurën e azilit, procedurën e Dublinit, mjetet ligjore efektive për procedurat e përsheptuara dhe bashkimin familjar.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-2-major-developments-asylum-european-union-2023>

3. Funksionimi i Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit



Për shkak të rritjes së mprehtë të numrit të njerëzve që kanë nevojë për mbrojtje në Evropë dhe sistemeve të tejmbushura kombëtare të pritjes, vendet e BE+ zbatuan në vitin 2023 nisma legjislative, praktike dhe nisma lidhur me politikat për të menaxhuar situatën e luhatshme. Në të njëjtën kohë, shqetësime për disa praktika brenda administratave kombëtare të azilit dhe pritjes u shprehën nga organizatat e shoqërisë civile, UNHCR-ja dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Rubrika 1. Mbrojtja e përkohshme për personat e zhvendosur nga Ukraina



Teksa agresioni ushtarak kundër Ukrainës hyri në vitin e tij të dytë, mbi 4,3 milionë shtetas jo të BE-së të cilët u larguan nga Ukraina vazhduan të priteshin me një status të përkohshëm mbrojtjeje në vendet e BE+, gjë që gjithashtu zgjati vlefshmërinë e mbrojtjes deri në mars 2025. Në vitin 2023, vendet e BE+ lëshuan mbi 1 milion vendime që garantonin mbrojtje të përkohshme, 99% e të cilave u përfituan nga shtetasit ukrainas. Krahasuar me nivelet e larta në fillim të luftës, vendimet që garantojnë mbrojtje të përkohshme kanë ardhur në rënie dhe kanë mbetur në një nivel më të ulët relativisht të qëndrueshëm që nga vera e vitit 2023.

Disa vende të BE+ lejuan që statusi i mbrojtjes së përkohshme të shndërrohej në leje qëndrimi për punësim ose bashkim familjar. Gjithashtu, disa vende e zgjeruan fushën e zbatimit të mbrojtjes së përkohshme për shtetasit ukrainas që ndodheshin jashtë Ukrainës në kohën kur nisi agresioni ushtarak. Nga ana tjetër, vende të tjera filluan të prezantojnë masa për të kufizuar kualifikueshmërinë për mbrojtje të përkohshme.

Gjykatat gjithashtu përcaktuan kritere të kualifikueshmërisë. Në çështjen *Azilkërkues kundër Sekretariatit Shtetëror për Emigracionin*, Gjykata Administrative Federale e Zvicrës (FAC) [vendosi](#) që ukrainasve që mbanin gjithashtu shtetësinë e një vendi të BE/EFTA+ të mos u garantohej mbrojtje e përkohshme. Gjykata Kushtetuese në Austri [konfirmoi](#) se mbrojtja e përkohshme vlen për shtetasit ukrainas që ishin larguar nga vendi pak para 24 shkurtit 2022, por në parim banonin atje. Gjykata Administrative e Mynihut në Gjermani [vendosi](#) në çështjen *Azilkërkues kundër Zyrës së Emigracionit* (M 4 S 23.2442) se partnerët e pamartuar të personave nga Ukraina nuk kualifikoheshin për mbrojtje të përkohshme. Gjykata arriti në të njëjtin konkluzion për çështjen M 4 K 23.2440. Vendimi i fundit u kthye nga Gjykata e Lartë Administrative e Bavarisë më 31 tetor 2023, me vendimin në çështjen 10 C 23.1793.

U prezantuan masa të veçanta, duke përfshirë bursa dhe mësimë gjuhe falas, për të mbështetur integrimin social dhe ekonomik të përfituesve të mbrojtjes së përkohshme në shoqëritë pritëse.



Akomodimi dhe strehimi i përshtatshëm vazhduan të ishin një tematikë e ngutshme, ndërsa integrimi në tregun e punës në përgjithësi u lehtësua. Megjithatë, afërsisht tre të pestat e vendimeve që garantonin mbrojtje të përkohshme në BE+ në vitin 2023 u lëshuan në favor të grave dhe vajzave, dhe mbi një të katërtat u lëshuan në favor të fëmijëve, duke krijuar një barrë për shumë gra ukrainase që të punësoheshin në vendin e tyre pritës. Gjithashtu, ukrainasit shpesh punësoheshin në pozicione që kërkonin nivele më të ulëta kualifikimi, pjesërisht për shkak të procedurave të gjata për njohjen e diplomave ose kualifikimeve.

Për të kuptuar më mirë nevojat e personave të zhvendosur nga Ukraina, EUAA-ja së bashku me OECD-në vazhduan të zhvillojnë anketime të emigrantëve që mbërrijnë nga Ukraina. Bazuar te rezultatet, në [qershor](#) dhe [tetor](#) 2023 u publikuan dy skeda informative. Gjithashtu, raporti “[Zërat në Evropë: Përvojat, shpresat, aspiratat e personave të zhvendosur me forcë nga Ukraina](#)” merr në shqyrtim dëshmitë e dorës së parë të mbledhura përmes anketimeve në zhvillim e sipër, si dhe paraqet tematikat mbizotëruese të ngritura nga kjo popullatë.

3.1. Aksesi në procedura



Në vitin 2023, vendet e BE+ morën mbi 1,1 milionë kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare, çka përbënte numrin më të madh që nga kriza e refugjatëve në periudhën 2015-2016. Në tremujorin e fundit të vitit 2023, numri i kërkesave të depozituara tejkaloi nivelet e vitit 2016. Numri i kërkesave të depozituara çdo muaj në vitin 2023 ishte pothuajse gjithmonë më i lartë se në vitin 2022, dhe mbi 90% ishin azilkërkues për herë të parë ashtu si në vitin 2022.

Gjermania kryesoi listën për sa i përket numrit të kërkesave të marra (334 000, +45% nga viti 2022) dhe përbënte rreth 30% të totalit. Tri vendet kryesore pasuese për numrin më të lartë të kërkesave të marra kishin së bashku 41% të totalit të kërkesave, me numra rekord në secilin prej tyre: Franca (167 000 kërkesa, +7% rritje), Spanja (162 000, +38%) dhe Italia (136 000, +63%).

Kur u shqyrtuan kërkesat për azil në raport me numrin e popullsisë, Qiproja kryesonte listën me rreth 13 000 kërkesa të depozituara për 1 milion banorë. Vende të tjera që patën nivele të konsiderueshme presioni nga fluksi i kërkesave për azil përfshinin Austrinë (6500 për 1 milion banorë), Greqinë (6200), Gjermaninë (4000), Luksemburgun (3800), Bullgarinë (3500), Slloveninë dhe Zvicrën (3400 secila).


Sirianët, afganët dhe turqit vazhduan të kryesonin radhët e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, duke përbërë mbi një të tretën e të gjitha kërkesave të depozituara në vendet e BE+ (*shihni figurën 1*). Shtetasit e Sirisë, të cilët përbënin rreth një të gjashtën e të gjithë azilkërkuesve, depozituan 181 000 kërkesa, çka përbënte një rritje prej 38% krahasuar me vitin 2022 dhe nivelin më të lartë që prej vitit 2016. Ata u pasuan me diferencë nga afganët, me 114 000 kërkesa, çka përbënte një rënie prej 11% krahasuar me një vit më parë. Turqit paraqitën një numër rekord prej 101 000 kërkesash, si dhe ruajtën pozicionin e tyre si grupi i tretë më i madh i azilkërkuesve. Kjo përbënte një rritje prej 82% në krahasim me vitin 2022, gati duke tejkaluar numrin e kërkesave nga afganët.

Numra rekord kërkesash u depozituan edhe nga shtetësi të tjera, duke përfshirë venezuelasit dhe kolumbianët, të cilët u renditën në vendin e katërt dhe të pestë. Pas përshkallëzimit të konfliktit izraelito-palestinez në tetor 2023, palestinezët depozituan numra rekord kërkesash për azil.



Në vitin 2023, vendet e BE+ vazhduan të hasin presion në kufijtë e tyre dhe u përballën me sfida në lidhje me numrin e lartë të mbërritjeve. Ndikimi i pushtimit rus të Ukrainës vazhonte të ushtronte presion mbi kufijtë e jashtëm lindorë të BE-së, ndërsa vendet në rajonin e Mesdheut u përballën me vështirësi lidhur me mbërritjen e vazhdueshme të emigrantëve nga deti. Vendet e prekura nga lëvizjet përgjatë rrugës ballkanike shtuan përpjekjet e tyre për kontrollin e kufijve. Presioni u ndje edhe në vendet e Evropës Qendrore, të cilat morën një numër kërkesash në rritje.

Figura 1. Kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare në vendet e BE+ sipas vendit të origjinës, 2023



Shënime: Nuk kishte të dhëna në dispozicion për Portugalinë për periudhën tetor-dhjetor 2023. Kufijtë në hartë nuk nënkuptojnë miratimin apo pranimin zyrtar nga Bashkimi Evropian.

Burimi: Të dhënat e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe Gatishmërisë (EPS) të EUAA-së, nga 1 shkurti 2024.

Në këtë situatë, vendet e BE+ u përqendruan në reduktimin dhe parandalimin e emigracionit të parregullt në BE, i cili herë pas here rrezikonte të ndikonte në aksesin efektiv në territor. Gjatë gjithë vitit 2023, institucionet dhe agjencitë e BE-së, UNHCR-ja dhe organizatat ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile shqyrtuan me imtësi politikën dhe praktikën në lidhje me sigurimin e aksesit efektiv në territor dhe procedurën e azilit. Ato shprehën shqetësimin për shkeljet e mundshme të të drejtave themelore në kufijtë e jashtëm dhe u bënë thirrje qeverive kombëtare dhe Komisionit Evropian për të garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe respektimin e parimit të *moskthimit* të refugjatëve.

Disa vende shpallën dhe mbajtën një gjendje të jashtëzakonshme, duke zbatuar rregulla që lejonin devijimin nga procedura e rregullt. Ato gjithashtu filluan të investojnë në përdorimin e teknologjisë për të garantuar sigurinë kufitare. Fluksi i shtuar i punës që vjen si pasojë e rritjes së numrit të kërkesave bëri që shumë vende të bëjnë rregullime në proceset e regjistrimit dhe strehimit, krahas riorganizimit të burimeve njerëzore për të trajtuar prapambetjen në përpunimin e kërkesave.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-31-access-procedures>



3.2. Procedura e Dublinit



Në vitin 2023, Komisioni Evropian dhe vendet e BE+ u përqendruan në rritjen e efektivitetit të Rregullores Dublin III. Shtetet anëtare filluan të zbatojnë zgjidhjet praktike të përcaktuara në “Udhërrëfyesin për përmirësimin e zbatimit të transferimeve në kuadër të Rregullores Dublin III” (udhërrëfyesi Dublin), i cili u miratua nga vendet e BE+ në takimin e Komitetit Strategjik për Emigracionin, Kufijtë dhe Azilin (SCIFA), më 29 nëntor 2022.

Zgjidhje të tilla praktike përfshinin, për shembull, rekrutimin dhe trajnimin e stafit, rishikimin e flukseve të punës dhe procedurave standarde të veprimit, si dhe ndërmarrjen ose vazhdimin e nismave të dixhitalizimit. EUAA-ja publikoi rekomandime të përditësuara mbi [zbatimin e transferimeve në kuadër të Rregullores Dublin](#) dhe mbi [bashkimin familjar në kuadër të procedurës së Dublinit](#), si dhe u nxorën skeda informative me informacione të përditësuara mbi transferimet në kuadër të Rregullores Dublin.

Masat e ndryshme dhanë rezultate premtuese, duke përmirësuar komunikimin midis njësive të Dublinit, duke kapërcyer pengesat në zbatimin e transferimeve në kuadër të Rregullores Dublin, duke shtuar burimet për të lejuar përmirësimin e procedurave të Dublinit dhe duke përforcuar pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së dhe vendimet gjyqësore. Komisioni Evropian paraqiti një numër praktikash të mira nga vendet e BE+ në një [dokument pune](#) të botuar në fund të vitit 2023.

Shumë nga njësitë e procesit të Dublinit vazhduan të përballeshin me presion gjatë vitit 2023, për shkak të numrit në rritje të azilkërkuesve. Në kuadër të planeve të saj operacionale, EUAA-ja siguroi mbështetje ndaj këtyre njësive në disa shtete anëtare. Ndikimi i pushtimit të Ukrainës te njësitë e Dublinit u reduktua në krahasim me vitin 2022, por vazhdoi të ndikojë te detyrat dhe fluksi i punës në shumë prej njësive.

GjDBE shpalli disa vendime paraprake mbi interpretimin e Rregullores Dublin III, në mënyrë të ngjashme me vitet e mëparshme. Shumë vende të BE+ vunë në dukje se zbatimi i disa prej këtyre vendimeve – për shembull [Çështjet e bashkuara C-323/21, C-324/21 dhe C-325/21](#) – nxorën në pah të tjera problematika praktike, dhe diskutimet brenda Grupit të Kontaktit të Komisionit Evropian ose rrjeteve të EUAA-së siguruan platforma të dobishme për identifikimin e zgjidhjeve lidhur me këto sfida.

Sipas të dhënave provizore që shkëmbehen rregullisht midis EUAA-së dhe 29 vendeve të BE+, në vitin 2023 u shpallën 176 000 vendime si përgjigje ndaj kërkesave të nisura në kuadrin e procedurës së Dublinit. Kjo përbënte një rritje prej 8% krahasuar me vitin 2022, duke rezultuar në totalin më të lartë vjetor të paktën që nga viti 2016. Numri i vendimeve mujore në kuadër të procesit të Dublinit ishte vazhdimisht mbi 14 000 midis korrikut dhe nëntorit 2023 si pasojë e rritjes së kërkesave për azil në vendet e BE+ gjatë së njëjtës periudhë.

Në përgjithësi, raporti vjetor midis vendimeve të marra për kërkesat në kuadër të procesit të Dublinit dhe kërkesave të depozituara për azil ishte 15%, i ngjashëm me vitin 2022.

Megjithëse disa vendime lidhur me kërkesat në kuadër të procedurës së Dublinit kishin të bënin me rastet e bashkimit familjar, raporti i qëndrueshëm midis vendimeve dhe kërkesave sugjeron se në vitin 2023 një numër në rritje i azilkërkuesve u zhvendosën nga vendi i parë i mbërritjes në një tjetër për të depozituar një kërkesë të re (referuar si lëvizje dytësore), duke ndikuar kështu në ngarkesën totale të çështjeve të azilit.



Në nivel vendesh, Franca dhe Gjermania vazhduan të merrnin numrin më të lartë të vendimeve në përgjigje ndaj kërkesave adresuar atyre, duke përbërë së bashku rreth tre të pestat e totalit të BE+. Në vitet e mëparshme, Italia nxori numrin më të lartë të vendimeve për kërkesat në kuadër të procedurës së Dublinit. Megjithatë, siç nuk ishte dokumentuar asnjëherë më parë, Kroacia u radhit si vendi i dytë, pasi vendimet që ajo shpalli pothuajse u trefishuan në krahasim me një vit më parë.

Në vitin 2023 pati një normë pranimi prej 72% në vendimet në përgjigje të kërkesave në kuadër të procedurës së Dublinit, çka nënkupton përqindjen e vendimeve pozitive (në mënyrë të shprehur apo të nënkuptuar) ndaj kërkesave, nga totali i të gjitha vendimeve të shpallura. Kjo ishte 12 pikë përqindjeje më shumë se në vitin 2022, çka përbën rritjen më të lartë që nga viti 2017.

Numri i transferimeve të zbatuara në kuadër të procesit të Dublinit (15 000) mbeti i qëndrueshëm në raport me vitin 2022, por gjithsesi shumë më i ulët se nivelet para COVID-19 (mbi dy të pestat më pak se në vitin 2019). Zbatimi i transferimeve në kuadër të procesit të Dublinit u pengua pjesërisht nga shtimi i presionit mbi autoritetet për azilin dhe pritjen, i shkaktuar nga rritja e mprehtë e mbërritjeve të parregullta gjatë gjithë vitit.

Neni 17, paragrafi 1 i Rregullores Dublin III u përdor si referencë rreth 7500 herë në vitin 2023, çka përbën një rritje prej tre të pestash nga viti 2022 - niveli më i lartë në 5 vite. Neni 17, paragrafi 1, është klauzolë vetëgjykimore, e cila i lejon shtetet anëtare të shqyrtojnë kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur nga një shtetas i një vendi të tretë ose nga një person pa shtetësi, edhe nëse shqyrtimi i kësaj kërkesë nuk është përgjegjësi e këtij shteti sipas kriterëve të parashikuara në rregullore.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-32-dublin-procedure>

3.3. Procedurat e veçanta për vlerësimin e nevojave për mbrojtje



Gjatë shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare në shkallë të parë, shtetet anëtare mund të përdorin procedura speciale në disa kushte të caktuara, për shembull procedurat e përshpejtuara, procedurat në kufi ose procedurat prioritare, duke respektuar njëkohësisht parimet dhe garancitë bazë të parashikuara nga legjislacioni i BE-së.

Zhvillimet legjislative në lidhje me procedurat në kufi në vitin 2023 varionin nga propozimet për prezantimin e procedurës për herë të parë deri te ndryshimet e kushteve për zbatimin e procedurës dhe të gjykatës kompetente për shqyrtimin e apeliave. Shumë vende të BE+ ndryshuan listat e tyre të [vendeve të sigurta të origjinës](#) dhe përcaktimet si vende të treta të sigurta, ndërsa disa vende të tjera filluan të punojnë për miratimin e listave të tilla. Referimi i bërë nga Këshilli grek i Shtetit në lidhje me përcaktimin e Turqisë si një vend i tretë i sigurt mbeti pa një vendim nga GjDBE në vitin 2023, ndërsa GjEDNj-ja përcaktoi masa të përkohshme për azilkërkuesit lidhur me të cilët Turqia konsiderohej si një vend i tretë i sigurt.



Kërkesat e depozituara pas lëvizjeve dytësore vazhduan të shkaktojnë vendime mospranimi dhe GjDBE-ja pritej të merrte vendim në vitin 2024 për përpunimin e kërkesave të depozituara nga persona të cilëve u është garantuar mbrojtje ndërkombëtare në një shtet tjetër anëtar, por nuk mund të kthehen për shkak të rrezikut të trajtimit çnjerëzor ose degradues.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-33-special-procedures-assess-protection-needs>

3.4. Përpunimi i kërkesave për azil në shkallë të parë



Vendet e BE+ ndërmorën një sërë masash për t'iu përgjigjur rritjes së numrit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare. Disa propozuan ndryshime legjislative për të përshpejtuar më tej procedurën e azilit, teksa u prezantuan metoda të reja pune, politika prioritizimi dhe rekrutim i stafit shtesë për të maksimizuar numrin e vendimeve të marra. Gjithashtu, shtetet anëtare testuan ndryshime në procedurë për të reduktuar kohëzgjatjen e intervistave personale. Disa vende të BE+ prezantuan sisteme të reja informacioni ose nisën projekte për dixhitalizimin e sistemeve të tyre. Autoritetet vendimmarrëse përdorën mësimet e nxjerra nga nismat e kaluara të vlerësimit të cilësisë, intensifikuan trajnimet për stafin dhe ndërmorën procese të reja të shqyrtimit të cilësisë për procedurat dhe vendimet në shkallë të parë.

OJQ-të vazhduan të ngrenë shqetësime në lidhje me vonesat në planifikimin e intervistave personale, mungesën e trajnimit të nëpunësve që zhvillojnë intervistat dhe kohëzgjatjen e procedurave të azilit. UNHCR-ja gjithashtu shprehu qëndrimin e saj për eksternalizimin e procedurave të azilit, pasi në vitin 2023 disa shtete anëtare morën në konsideratë transferimin e azilkërkuesve drejt vendeve të treta për përpunimin e kërkesave të tyre për azil. Përdorimi i IA-së në proceset e emigracionit u identifikua gjithashtu si një temë që përbënte shqetësim.

Vendimet dhe mbylljet e çështjeve në shkallë të parë

Në vitin 2023, vendet e BE+ shpallën rreth 677 000 vendime të shkallës së parë, duke arritur kështu nivelin më të lartë që nga viti 2017. Për të dytin vit radhazi, Gjermania vazhdoi të renditej e para ndër vendet e BE+ për numrin e vendimeve të shpallura (rreth 219 000, çka përbën një të tretën e totalit të BE+). Ajo u pasua me diferencë nga Franca (133 000) dhe Spanja (90 000). Këto tri vende të marra së bashku shpallën dy të tretat e të gjitha vendimeve të shkallës së parë. Por tendencat ndryshonin nga një vend në tjetrin: ndërsa Gjermania regjistroi rritjen më të madhe absolute në vendimmarrje ndër vendet e BE+ në krahasim me vitin 2022 (+21 000), e kundërta ndodhi në Spanjë (-13 000). Ndërkohë, në Francë nivelet e vendimmarrjes mbetën të qëndrueshme.

Për të tretin vit radhazi, shumica e vendimeve u morën për kërkesat e paraqitura nga sirianët (132 000 vendime) dhe afganët (89 000), duke përbërë bashkërisht një të tretën e të gjitha vendimeve në BE+. Rritje absolute të konsiderueshme në vendimet e shpallura janë konstatuar edhe për shtetasit e: Turqisë (38 000 vendime të shkallës së parë), Venezuelës (45 000), Marokut (16 000), Gjeorgjisë (23 000), Rusisë (10 000), Republikës Demokratike të Kongos (11 000), Eritresë (12 000) dhe Ukrainës (10 000).

Marrja e vendimeve për kërkesat për azil përbën vetëm një nga mënyrat për mbylljen e një çështjeje azili. Ndërprerjet dhe format e tjera të mbylljes së çështjeve gjithashtu kontribuojnë



në fluksin dalës të përgjithshëm në shkallën e parë. Për rrjedhojë, në vitin 2023, numri i përgjithshëm i çështjeve që dolën nga sistemi i azilit në shkallën e parë (duke kombinuar vendimet e shkallës së parë, ndërprerjet si pasojë e tërheqjeve dhe format e tjera të mbylljes) arriti gjithashtu nivelin më të lartë në 6 vite (me rreth 863 000).


Për të pasqyruar me saktësi nivelin e presionit mbi sistemet kombëtare të azilit, numri i kërkesave të depozituara (fluksi në hyrje) duhet të ballafaqohet përkundrajt të gjitha mbylljeve të çështjeve (fluksi në dalje). Kjo tregon se hendeku midis fluksit në hyrje të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare dhe fluksit në dalje të çështjeve që dalin nga sistemi i azilit në shkallën e parë vazhdoi të zgjerohej duke arritur nivelin më të lartë në 5 vite. Me fjalë të tjera, në vitin 2023, sistemi i azilit në shkallën e parë mori rreth 280 000 çështje më shumë sesa arriti të përpunojë. Kjo shënoi një rritje të akumulimit të ngarkesës së çështjeve me 66% nga viti 2022, gjë që kontribuoi në vazhdimin e tendencës së dukshme që nga mesi i vitit 2021 në bazë të së cilës fluksi në hyrje e tejkalonte vazhdimisht atë në dalje.

Çështjet në pritje në shkallën e parë

Hendeku në zgjerim të vazhdueshëm midis kërkesave dhe mbylljeve të çështjeve çoi në numrin më të lartë të çështjeve në pritje në 8 vitet e fundit - një nivel më i lartë është regjistruar vetëm në vitin 2015 (*shihni figurën 2*).

Në fund të vitit 2023, rreth 883 000 çështje ishin në pritje të një vendimi në shkallë të parë (një rritje me dy të pestat nga fundi i vitit 2022). Ngarkesa e çështjeve përfshinte një sërë shtetësish, por numri më i madh u përkiste sirianëve dhe turqve. Gjysma e të gjitha rasteve në BE+ qëndruan në pritje për më shumë se 6 muaj.

Figura 2: Numri i çështjeve në pritje në shkallë të parë në vendet BE+ në fund të vitit, 2015-2023



Shënim: Nuk kishte të dhëna në dispozicion për Portugalinë për periudhën tetor-dhjetor 2023.
Burimi: Të dhënat e EPS-së së EUAA-së, nga 1 shkurti 2024.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-34-processing-asylum-applications-first-instance>



3.5. Përpunimi i kërkesave për azil në shkallë të dytë ose në shkallët më të larta



Në vitin 2023, zhvillimet në shkallën e dytë u përqendruan tek e drejta për akses në procedurën e apelimit dhe tek organet kompetente që duhet të shqyrtojnë apelimin në varësi të rrethanave. Fusha e zbatimit e apelimeve në çështjet e mbrojtjes ndërkombëtare (duke përfshirë kërkesën për të siguruar një shqyrtim *ex nunc* të fakteve dhe elementeve të çështjes) dhe efekti pezullues i apelimeve ishin objekt i ndryshimeve legislative dhe rishikimit gjyqësor. Disa vende përforcuan ligjet e tyre për të drejtën për seancë dëgjimore para një organi apeli, dhe disa vendime theksuan rëndësinë e kësaj mbrojtjeje procedurale lidhur me apelimin. Përveç kësaj, gjykatat theksuan nevojën për të garantuar që gjatë apelimit të mund të sigurohej një përkthyes, intervistues ose gjyqtar i të njëjtit seks.

Ashtu si çdo vit, organet e apelit pezulluan shqyrtimin e çështjeve për apel për profile specifike të azilkërkuesve (për shembull për ata nga Rripi i Gazës dhe Sudani) për shkak të situatave në zhvillim e sipër. Vendet gjithashtu përditësuan udhëzimet bazuar në zhvillimet në vendet e origjinës.

Kohëzgjatja e apelimit të çështjeve të azilit përbënte një aspekt shqetësues për autoritetet kombëtare. Organizatat e shoqërisë civile u kërkuan me urgjencë shumë prej vendeve të BE+ marrjen e vendimit brenda afateve të arsyeshme kohore. Dixhitalizimi i procedurave të apelimit në çështjet e mbrojtjes ndërkombëtare vazhdoi gjatë gjithë vitit 2023, përmes seancave dëgjimore në distancë.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-35-processing-asylum-applications-second-or-higher-instances>

3.6. Pritja e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare



Sfidat nga vitet e mëparshme vazhduan në vitin 2023 me pritjen e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare. Autoritetet pritëse në shumicën e vendeve të BE+ ishin ende të shqetësuara lidhur me sigurimin e akomodimit të përshtatshëm për secilin azilkërkues, për shkak të raportimeve të shpeshta të të pastrehëve, kushteve tepër të varfra apo nën standard të jetesës dhe mungesës së shërbimeve mbështetëse, nga organizatat ndërkombëtare, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, avokatët e popullit dhe organizatat e shoqërisë civile. Situata vazhdoi të ndikojë negativisht tek azilkërkuesit me nevoja të veçanta dhe të cenueshëm, siç janë fëmijët, gratë, azilkërkuesit LGBTIQ ose ata me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore (*shihni seksionin 4*). Gjykatave iu bë shpesh thirrje për të siguruar akses në kushtet materiale të pritjes, si dhe kushte dinjitoze për të gjithë azilkërkuesit.

Krahas adresimit të nevojave urgjente, autoritetet kombëtare në shumë vende vazhduan përpjekjet e tyre në kërkim të zgjidhjeve strukturore me qëllim garantimin e sistemeve fleksibël dhe të qëndrueshme të pritjes. Një gjë e tillë sillte në mënyrë të pashmangshme ndryshime, për shembull, në kuadrin institucional, strukturën e financimit dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me grupet e tjera të interesit. Duke qenë se sistemeve të pritjes iu desh të përballeshin me rritjen e kërkesës dhe me kosto më të larta të energjisë, siç përshkruhet në



detaje në një **përditësim të posaçëm të situatës** të EUAA-së, iu dha më shumë rëndësi qëndrueshmërisë së strukturave në aspektin mjedisor.

Presioni mbi sistemin e pritjes shërbeu si katalizator për rishikimin dhe zbatimin më strikt të rregullave lidhur me të drejtën për kushte të pritjes. Ndryshimet në legjislacion në përgjithësi sqaronin përfundimin e periudhës së pritjes. Ashtu si edhe vitet e mëparshme, fluksi në dalje nga qendrat e pritjes shpesh hasi në ngërçe ose edhe ngadalësime, pasi përfituesit e njohur të mbrojtjes ndërkombëtare u përballën me sfida në gjetjen vetë të një akomodimi në tregun privat. Propozimet e politikave synonin të lehtësonin këtë kalim dhe të mundësonin hyrje më të shpejtë në tregun e punës.

Teksa sfidat ka të ngjarë të jenë ende të pranishme, autoritetet kombëtare duhet të vazhdojnë të kërkojnë zgjidhje fleksibël dhe të qëndrueshme lidhur me sistemin e pritjes, me qëllim përshtatjen në mënyrë efikase me numrin dhe profilet në ndryshim të azilkërkuesve dhe rezidentëve në qendrat e pritjes.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-36-reception-applicants-international-protection>

3.7. Aspektet e ndalimit që përfshijnë azilkërkuesit dhe ish-azilkërkuesit



Në vitin 2023, praktikat dhe kushtet në qendrat e ndalimit vazhduan të shqyrtoheshin me imtësi nga institucionet monitoruese dhe gjyqësore ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare. U intensifikuan diskutimet publike në lidhje me ndalimin në kufi të personave që mbërrijnë në mënyrë të parregullt dhe mundësinë e tyre për të aksesuar procedurën e azilit ose për të përfituar shërbime konsulence dhe këshillimi ligjor. Kushtet në qendrat e ndalimit në kufi shpesh përshkruheshin si alarmante nga organizatat ndërkombëtare dhe ato të shoqërisë civile. GjEDNj-ja shpalli vendime për çështje nga vitet e mëparshme në të cilat dënonte kushtet dhe praktikat në kufi. GjEDNj-ja dhe gjykatat kombëtare shpallën gjithashtu vendimin kundër ndalimit të azilkërkuesve me nevoja të veçanta, veçanërisht të fëmijëve.

Përgjithësisht, vendet e BE+ zgjeronin motivimet për ndalimin e të huajve, duke përfshirë aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe rrisnin kohëzgjatjen e mundshme të ndalimit të emigrantëve. Ndryshimet legjislative në disa vende përfshinin mundësinë për të ndaluar azilkërkuesit që kanë rrezik të arratisen teksa presin një transferim drejt një vendi tjetër të BE+ në kuadër të Rregullores Dublin III.

Temat kryesore në diskutimet e politikave përfshinin ndalimin e të huajve në pritje të kthimit, zbatimin e parimit të *moskthimit* në raste të tilla dhe mundësinë reale për të zbatuar vendimet për kthim. Këto fusha u pasqyruan në mënyrë të plotë edhe në zhvillimet jurisprudenciale në vitin 2023.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-37-aspects-detention-involving-asylum-applicants-and-former-applicants>



3.8. Aksesit në informacion



Autoritetet kombëtare dhe grupet e tjera të interesit vazhduan të përpiqen për lehtësimin e disponueshmërisë së informacionit, duke përfshirë në formate dhe në gjuhë të ndryshme. Disa vende hartuan informacion të përshtatur për audiencë specifike, të tilla si azilkërkuesit e mitur dhe personat e zhvendosur nga Ukraina.

Disa vende nisën fushata informimi të përqendruara në shkurajimin e shtetasve të vendeve me shkallë të ulët njohjeje, nga ndërmarrja e udhëtimeve të rrezikshme në BE vetëm për t'iu refuzuar kërkesa. Disa të tjera u përqendruan në ndërgjegjësimin e radhëve të azilkërkuesve kërkesa e të cilëve ishte refuzuar, rreth mundësisë së kthimit vullnetar në vendin e origjinës.

Pas shumë vitesh punë, EUAA-ja lançoi një portal të ri gjithëpërfshirës, [Let 's Speak Asylum](#) (Rreth azilit), ku grupeve të interesit puna e të cilëve përfshin ofrimin e informacionit në sistemin e azilit u vihen në dispozicion metodologjitë e rekomanduara dhe mjete praktike.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-38-access-information>

3.9. Asistenca dhe përfaqësimi ligjor



Në vitin 2023, vendet e BE+ vazhduan përpjekjet për të përmirësuar aksesin në ndihmën juridike dhe cilësinë e kësaj të fundit në të gjitha fazat e procedurës së azilit. Zhvillimet përfshinin ndryshime institucionale, trajnime të specializuara për ofruesit, si dhe ndryshimin e kriterëve të kualifikueshmërisë për të punuar si ofrues i ndihmës juridike në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare.

Megjithatë, pati raportime të sfidave lidhur me aksesimin e ndihmës juridike, veçanërisht në kufij ose në qendrat e ndalimit. Për shembull, në forume të ndryshme u ngrit problematika e mungesës së komunikimit me një avokat dhe e mungesës së të drejtës efektive për ndihmë juridike për azilkërkuesit në qendrat e ndalimit. Disa vende ndryshuan dispozitat kombëtare për të përforcuar të drejtën e azilkërkuesve në qendrat e ndalimit për të kontaktuar me anëtarët e familjes, konsulentët ligjorë dhe organizatat përkatëse.

Me mbërritjen e vazhdueshme nga Ukraina të personave të zhvendosur, disa vende të BE+ vazhduan të japin informacion ligjor dhe ndihmë lidhur me procedurën e mbrojtjes së përkohshme.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-39-legal-assistance-and-representation>



3.10. Shërbimet e përkthimit



Në vitin 2023, autoritetet kombëtare, gjykatat dhe tribunalet, organizatat e shoqërisë civile dhe ofruesit e shërbimeve bënë përpjekje për të përmirësuar aksesimin dhe cilësinë e shërbimit të përkthimit në procedurat e azilit dhe sistemin e pritjes. Në mbarë vendet e BE+, rritja e kërkesave për azil çoi në rritjen e nevojave për shërbime përkthimi. Në disa vende, ku profilet e azilkërkuesve mbetën të ngjashme me vitet e mëparshme, nuk pati nevoja të reja të konsiderueshme. Megjithatë, në vendet që priten azilkërkues me profile të ndryshme, u vunë re sfida shtesë në lidhje me sigurimin e shërbimeve efektive të përkthimit. Në tërësi, mungesa e kompetencave linguistike në gjuhë të caktuara, padisponueshmëria e përkthimit për shërbime të caktuara, si dhe standardet heterogjene vazhduan të ndikojnë në të drejtat procedurale të azilkërkuesve dhe aksesin e tyre në shërbime, siç është kujdesi shëndetësor.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-310-interpretation-services>

3.11. Informacioni për vendin e origjinës



Zhvillimet kryesore në prodhimi e IVO-së (informacioni për vendin e origjinës) në vitin 2023 u përqendruan në përmirësimin e metodologjive, duke përfshirë përmes standardizimit të raportimit; në përmirësimin e bashkëpunimit përmes kuadrove dypalëshe, ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe me organizatat e shoqërisë civile; në rritjen e aksesueshmërisë së IVO-së me anë të publikimit të raporteve dhe burimeve; si dhe në zgjerimin e objektit të informacionit duke adresuar fusha specifike më në detaje.

Ashtu si vitet e mëparshme, njësitë e IVO-së vazhduan të përqendroheshin te disa prej vendeve më të zakonshme të origjinës së azilkërkuesve në Evropë, konkretisht Afganistani, Siria dhe Iraku. Vendet e BE+ monitoruan gjithashtu zhvillimet në Amerikën Latine, me rritjen e interesit për rajonin. Pas pushtimit rus të Ukrainës, u rritën ndjeshëm nevojat për IVO lidhur me situatën e sigurisë në Rusi dhe Ukrainë. Kjo tendencë vazhdoi edhe në vitin 2023, dhe njësitë kombëtare të IVO-së prodhuan materiale për të dyja vendet, duke realizuar gjithashtu misione faktmbledhëse, kur ishte e mundur.

Sfidat e raportuara në fushën e prodhimit të IVO-së përfshinin mungesat e stafit; mungesën e aksesit në informacionet mbi zhvillimet e fundit për shkak të konfliktit, shqetësimeve të sigurisë dhe aksesit të kufizuar në vendet me qeveri autoritare; si dhe një rritje në kërkesat urgjente që shtojnë ngarkesën mbi burimet e disponueshme.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-311-country-origin-information>



3.12. Mungesa e shtetësisë në kontekstin e azilit



Në kontekstin e azilit, mungesa e shtetësisë mund të ndikojë në procesin e vendimmarrjes për kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare, si edhe në mbrojtjet procedurale të azilkërkuesit. Në vitin 2023, mungesa e shtetësisë, vazhdoi të përbënte një temë me rëndësi në axhendën e BE-së. Kjo pasi aspektet e lidhura me mungesën e shtetësisë lidheshin ngushtë me dy zona kryesore konflikti në vitin 2023, përkatësisht Palestinën dhe Ukrainën.

Në vitin 2023, në vendet e BE+ u depozituan rreth 2300 kërkesa për azil nga persona pa shtetësi - situatë kjo në pajtueshmëri me vitin 2022. Gjatë gjithë vitit, vendimet e marra në shkallë të parë për azilkërkuesit pa shtetësi në vendet e BE+ ishin vetëm pak më shumë se 1200. Shkalla e njohjes e azilkërkuesve pa shtetësi ishte 53% në vitin 2023, relativisht e ngjashme me vitet e kaluara, por shumë më e ulët se gjatë krizës së refugjatëve të viteve 2015-2016 (kur gati 9 nga 10 vendime ishin pozitive). Në fund të vitit 2023, kishte 1900 çështje lidhur me azilkërkuesit pa shtetësi të cilat ishin në pritje në shkallë të parë.

Zhvillime të shumta legjislative synuan të rrisin shkallën e njohjes dhe të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të personave pa shtetësi, duke përfshirë azilkërkuesit pa shtetësi dhe përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare, si dhe fëmijët e tyre. Mes zhvillimeve pozitive, organizatat e shoqërisë civile theksuan se nevojitet më shumë punë për identifikimin dhe për mbrojtjen e plotë të të drejtave të personave pa shtetësi.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-312-statelessness-context-asylum>

3.13. Përmbajtja e mbrojtjes



Përmbajtja e mbrojtjes u referohet të drejtave që përfituesit e një forme të mbrojtjes gëzojnë në vendin e azilit, si dhe detyrimeve përkatëse. Mbrojtja jepet kur azilkërkuesit marrin një vendim pozitiv për dhënien e statusit të refugjatit ose mbrojtjes plotësuese (të referuara edhe si statuset e harmonizuara me BE-në). Shkalla e njohjes i referohet numrit të rezultateve pozitive si përqindje e numrit të përgjithshëm të vendimeve për kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare. Ndërkohë që format kombëtare të mbrojtjes u japin një status mbrojtjeje shtetasve të vendeve të treta, ato statuset – të cilat nuk janë të harmonizuara nëpër vendet e BE+ – përgjithësisht nuk përfshihen në llogaritjen e shkallës së njohjes.

Në vitin 2023, shkalla e njohjes në shkallë të parë për format e mbrojtjes të rregulluara në nivel BE-je pësori rritje, për të tretin vit radhazi, duke arritur në 43%. Kjo ishte shkalla më e lartë që nga viti 2016 (kur 57% e vendimeve jepnin statusin e refugjatit ose mbrojtje plotësuese). Rritja u nxit kryesisht nga rritja e shkallës së njohjes për afganët, irakenët, palestinezët dhe ukrainasit dhe nga rritja e numrit të vendimeve të shpallura për sirianët. Në total, 54% e të gjitha vendimeve pozitive garantuan statusin e refugjatit, ndërsa 46% garantuan mbrojtje plotësuese.



Përtej statuseve të rregulluara nga BE, vlen të përmendet se mbi një e katërta e vendimeve negative për statute të rregulluara nga BE garantuan një formë kombëtare mbrojtjeje, e cila autorizoi qëndrimin për arsye humanitare.

Kombësitë me shkallën më të lartë të njohjes në vitin 2023 përfshinin sirianët (94%), ukrainasit (92%), palestinezët (87%), jemenasit (84%), eritreasit (83%) dhe bjellorusët (81%).

Shtrirja dhe cilësia e të drejtave dhe shërbimeve që marrin përfituesit e mbrojtjes formësojnë perspektivat e integritit të tyre e në shoqëritë pritëse. Në vitin 2023, ndryshimet legjislative dhe ato të politikave u përqendruan te bashkimi familjar dhe format kombëtare të mbrojtjes, ndërsa disa vende të BE+ vazhduan të zhvillonin politika dhe strategji integrimi të përshtatura për profilet e përbashkëta të përfituesve të mbrojtjes në vendet përkatëse, me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile. Shumë nisma u përqendruan në lehtësimin e procedurave administrative që përfituesit e mbrojtjes përdorin për aksesimin e të drejtave përkatëse.

Rasti i 20-vjetorit të hyrjes në fuqi të Direktivës “Për ribashkimin familjar” u pasua nga botime dhe rekomandime për përmirësimin e zbatimit të saj. GjDBE-ja dhe gjykatat kombëtare vazhduan të japin udhëzime për zbatimin praktik të saj, duke sqaruar rregullat përkatëse mbi fushën e zbatimit dhe kriteret.

Nisma të shumta u përqendruan në përcaktimin apo përshtatjen e rregullave dhe kriterëve për format kombëtare të mbrojtjes. Për të shmangur një pasiguri juridike, disa vende të BE+ dhanë leje qëndrimi bazuar në arsye humanitare apo mjekësore, në përpjekje për të mbrojtur interesat më të mira të fëmijës ose për të respektuar parimin e *moskthimit*.

Natyrisht, në vitin 2023 pati shumë nisma integrimi të synuara për përfituesit e mbrojtjes së përkohshme, të cilat përfshinin mbështetjen për aksesin në arsim dhe trajnime gjuhësore. Organizatat e shoqërisë civile luajtën një rol kyç në ofrimin e shërbimeve përkatëse dhe në integrimin e përpjekjeve nga autoritetet në nivel komuniteti.

Ndër sfidat e raportuara, u vu re se mungesa apo natyra e kufizuar e alternativave të strehimit social dhe mungesa e strehimit me kosto të ulët në tregjet lokale krijuan pengesa lidhur me gjetjen e akomodimit për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-313-content-protection>



3.14. Risistemimi dhe pranimet për motive humanitare



Vendet e BE+ u përpoqën të përmbushin angazhimet e tyre lidhur me risistemimin në vitin 2023, ndërkohë që përballeshin me sfida specifike në nivel kombëtar. Nevojitej një riorganizim i prioriteteve për shkak të mungesës së ambienteve akomoduese për të pritur refugjatët e risistemuar. Në të njëjtën kohë, situata emergjence prekën vendet e treta ku refugjatët në rrezik prisnin të transferoheshin, siç ishte tërmeti në Turqi.

Në total, në vitin 2023 në BE+ mbërritën rreth 15 000 njerëz nga vendet e treta në kontekstin e risistemimit ose pranimeve për motive humanitare. Ky ishte numri më i ulët që nga viti 2016, me përjashtim të vitit 2020, kur transferimet u penguan ndjeshëm për shkak të pandemisë së COVID-19.

Roli i organizatave të shoqërisë civile vazhdoi të mbetej i rëndësishëm në zbatimin e risistemimit dhe formave komplementare, duke përfshirë programet e pranimit për motive humanitare. Organizatat e shoqërisë civile morën pjesë në referimin e refugjatëve, kontribuan në realizimin me sukses të evakuimeve të refugjatëve në rrezik dhe mbështetën transferimin e sigurt të refugjatëve të përzgjedhur, në varësi të marrëveshjeve të nënshkruara me vendet e BE+. Roli i tyre në ofrimin e shërbimeve të pritjes, veçanërisht ato të strehimit, ishte kyç për të lehtësuar presionin mbi sistemet e pritjes në disa vende.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-314-resettlement-and-humanitarian-admissions>



4. Fëmijët dhe personat me nevoja të veçanta në procedurën e azilit



Në vitin 2023, disa vende të BE+ raportuan një numër vazhdimisht të lartë të azilkërkuesve me nevoja të veçanta, duke filluar nga azilkërkuesit me aftësi të kufizuara fizike ose mendore deri te viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe fëmijët që mbërrijnë të pashoqëruar në BE. Në situatën e përgjithshme të vonesave të shpeshta në procedurën e azilit dhe të sistemeve të ngopura të pritjes, qeveritë vazhduan të kërkojnë zgjidhje për të siguruar kushte dinjitoze dhe siguri për kategoritë më të cenueshme. Herë pas here, ndryshimet legislative dhe ato të politikave lejonin devijime nga standardet më strikte, ndërkohë që organizatat ndërkombëtare dhe ato të shoqërisë civile theksuan rreziqet e zbatimit të këtyre shmangieve për periudha afatgjata.

Autoritetet në vendet me numra të lartë të mbërritjeve të njëkohshme u përballën me vështirësi në identifikimin dhe vlerësimin e duhur të nevojave të veçanta. Vendimet e GjEDNj-së të shpallura në vitin 2023 - referuar situatave të periudhës 2018-2020 - shërbyen si një kujtesë se mangësitë në identifikimin dhe mbështetjen e azilkërkuesve me nevoja të veçanta mund të kenë një ndikim dramatik në jetën e tyre. Gjithashtu, [hulumtimi i EUAA-së](#) zbuloi mangësi të konsiderueshme për sa u përket të dhënave, pasi vendet e BE+ në përgjithësi nuk mbledhin apo regjistrojnë të dhëna lidhur me cenueshmëritë, kryesisht për shkak të shqetësimeve lidhur me mbrojtjen e të dhënave. Prandaj, është e vështirë të identifikohen llojet më të zakonshme të aftësive të kufizuara apo cenueshmërive të konstatuara në radhët e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare.

Në tetor 2023, Konventa e Stambollit hyri në fuqi për BE-në, duke përfshirë dispozitat në lidhje me azilin dhe parimin e *moskthimit*. Në nivel vendi, përpjekjet u përqendruan në parandalimin e dhunës kundrejt grave dhe vajzave, si dhe në mbështetjen ndaj grave viktime të dhunës. Hartëzimet gjithëpërfshirëse zbuluan ende shumë mangësi në sistemet e azilit dhe të pritjes, çka vinte në rrezik sigurinë e grave dhe vajzave. Këto mangësi dhe ndikimi i tyre i dëmshëm u morën në shqyrtim dhe u gjykuan gjithashtu nga gjykatat.

Autoritetet kombëtare bënë përpjekje për të përmirësuar reagimin e sistemeve të azilit dhe pritjes ndaj nevojave të azilkërkuesve me SOGIESC (orientim seksual, identitet gjinor, shprehje gjinore, karakteristika seksuale) të ndryshme. IVO-të e sakta dhe në kohë u përqendruan në situatën e personave LGBTIQ, për të vlerësuar siç duhet situatën e tyre. Për këtë qëllim, në vitin 2023, EUAA-ja përditësoi [Udhëzuesin kërkimor të IVO-së për LGBTIQ](#) për t'u ardhur në ndihmë profesionistëve. Në shkallën e dytë, gjykatat shpesh ndërhyjnë dhe shfuqizuan vendimet negative të shkallës së parë për të siguruar mbrojtje për këtë profil të azilkërkuesve.


Duke qenë se pjesa më e madhe e personave që kërkojnë mbrojtje të përkohshme në Evropë përfshinte gra dhe fëmijë, problematikat e trafikimit të qenieve njerëzore vazhduan të ishin me rëndësi në vendet e BE+, duke sjellë kështu masa të mëtejshme parandaluese dhe mbrojtëse në vitin 2023. Pas propozimit të Komisionit Evropian nga dhjetori 2022 për rishikimin e Direktivës “Për luftën kundër trafikimit”, Parlamenti Evropian miratoi mandatin e tij për negociatën me shtetet anëtare, i cili nisi në nëntor 2023 me Këshillin Evropian. Më pas, Parlamenti Evropian dhe Këshilli arritën një marrëveshje informale, në janar 2024, për zgjerimin e fushës së zbatimit të direktivës aktuale. Në nivel kombëtar, vendet e BE+



prezantuan ndryshime për përmirësimin e identifikimit, referimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit. Disa vende u përqendruan gjithashtu në monitorimin e situatës, duke urdhëruar studime për të analizuar tendencat aktuale.

Në vitin 2023, në vendet e BE+ u depozituan 41 000 kërkesa për azil nga të miturit e vetëdeklaruar të pashoqëruar. Ky nivel ishte i ngjashëm me atë të vitit 2022 (-5%) dhe i dyti më i lartë i regjistruar që nga viti 2015. Numri i kërkesave nga të miturit e pashoqëruar mbeti i qëndrueshëm, duke përbërë rreth 4% të të gjitha kërkesave të depozituara në vendet e BE+. Një pjesë e konsiderueshme e azilkërkuesve të mitur vinin nga Siria dhe Afganistani, duke i korresponduar bashkërisht tri prej çdo pesë kërkesave nga të miturit e vetëdeklaruar të pashoqëruar në vendet e BE+.

Figura 3: 10 vendet kryesore të BE+ me numrin më të madh të kërkesave nga të miturit e vetëdeklaruar të pashoqëruar për vitin 2023 në raport me vitin 2022, si dhe numri i kërkesave të depozituara nga shtetësitë kryesore të të miturve të pashoqëruar për vitin 2023



Shënim: Nuk kishte të dhëna në dispozicion për Portugalinë për periudhën tetor-dhjetor 2023.

Burimi: Të dhënat e EPS-së së EUAA-së, nga 1 shkurti 2024.

Kërkesat e tërhequra në mënyrë të nënkuptuar nga të miturit e pashoqëruar u reduktuan me më shumë se një të tretat nga niveli maksimal në vitin 2022, veçanërisht nga të miturit e pashoqëruar afganë. Një gjë e tillë sugjeron se ka pasur një reduktim të mundshëm të lëvizjeve dytësore nga të miturit e pashoqëruar brenda vendeve të BE+.

Numri vazhdimisht i lartë i kërkesave nga fëmijët e pashoqëruar në disa vende të BE+ nxit ndryshime të shumta në pritjen e tyre. Shumë problematika vazhduan të ishin të pranishme dhe kushtet e pritjes për fëmijët shpesh ishin nën ato optimale. Ndryshimet legislative dhe të politikave synuan të përshpejtojnë proceset dhe të sigurojnë mbështetjen e duhur, ndërkohë që OJQ-të theksonin rreziqet që këto devijime mund të sjellin në praktikë.

Gjithashtu, në disa vende të BE+ u raportua mungesa e kujdestarëve për azilkërkuesit e mitur të pashoqëruar. Për të ofruar udhëzime dhe për të ndihmuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve, Agjencia për të Drejtat Themelore (FRA) hartoi një [manual për trajnuesit](#) e kujdestarëve, i cili plotësohet më tej nga një platformë e mësimi elektronik. Përveç kësaj, së



bashku me EUAA-në, u zhvilluan dy udhëzues praktikë për kujdestarët që do të shërbenin si një [hyrje në mbrojtjen ndërkombëtare](#) dhe në [procedurën e azilit](#). FRA-ja dhe Këshilli i Evropës publikuan gjithashtu një [udhëzues](#) për nëpunësit e kufirit dhe autoritetet e tjera, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në kufijtë e Evropës.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-4-children-and-people-special-needs-asylum-procedure>

5. Mbështetja e EUAA-së në vitin 2023



Me vazhdimin e presioneve të flukseve migratore dhe nevojave komplekse të mbrojtjes në Evropë, Agjencia zgjeroi mbështetjen e saj operacionale dhe teknike për të adresuar modelet në zhvillim. Si aktor integral në përgjigjen kolektive të BE-së në adresimin e nevojave të miliona personave të zhvendosur, EUAA-ja kontribuoi efektivisht në zbatimin e zgjidhjeve të mbrojtjes në të gjithë Evropën, ndër të tjera duke ofruar ndihmë për vendet që presin numra të lartë të personave të zhvendosur nga Ukraina.

Për të ofruar informacion të bazuar në prova për një sërë audiencash, duke përfshirë politikëbërësit, EUAA-ja vazhdoi të mbledhë, përpunojë, sintetizojë dhe analizojë informacione mbi tema specifike, zhvillimet më të fundit, temat e reja dhe parashikimet në fushën e azilit. Në përputhje me [udhërrëfyesin për konvergjencën](#) të Presidencës Franceze të Këshillit të BE-së, EUAA-ja zhvilloi një [studim pilot](#) për të analizuar praktikën e vendimmarrjes për kërkesat për azil dhe shkakun e dallimeve mes shteteve anëtare në shkallën e mbrojtjes, veçanërisht në lidhje me vendet e origjinës për të cilat janë hartuar [shënime udhëzuese](#) nga Agjencia. Studimi zbuloi se ndryshimet në shkallën e njohjes vinin si pasojë e ndërveprimit kompleks të faktorëve të shumtë, siç janë dallimet në sistemet kombëtare dhe praktikën e vendimmarrjes të cilat ndikohen nga politikat, udhëzimet dhe jurisprudenca kombëtare. Studimi gjithashtu nxori në pah se produktet dhe veprimtaritë e EUAA-së ndihmojnë në arritjen e konvergjencës në praktika.

Agjencia kreu gjithashtu një [vlerësim](#) të thelluar të përdorimit dhe ndikimit të produkteve të saj të informimit dhe udhëzimit të vendeve, i cili zbuloi se të dyja produktet e EUAA-së - informacioni i vendit të origjinës dhe produktet udhëzuese të vendeve - ishin përdorur gjerësisht. Të parat ishin përdorur kryesisht nga nëpunësit e çështjeve dhe të dytat kryesisht nga politikëbërësit. Vlera e shtuar e produkteve të EUAA-së në krahasim me burimet kombëtare është besueshmëria e tyre, përdorimi i vazhdueshëm i një metodologjie rigoroze dhe niveli i harmonizimit.

Trajnimi i zhvilluar dhe i ofruar nga Agjencia mbështeti zbatimin praktik të CEAS duke ndihmuar nëpunësit e sistemit të azilit dhe pritjes të përmirësojnë njohuritë, aftësitë dhe autonominë e tyre për të zbatuar procedura efikase dhe të drejta, në përputhje me standardet e BE-së. Në total, në vitin 2023 u regjistruan mbi 13 000 pjesëmarrje në veprimtaritë trajnuese të EUAA-së, si dhe u trajnuan më shumë se 7500 nxënës.

Një fushë kryesore e punës së EUAA-së është dhënia e ndihmës operacionale dhe teknike, veçanërisht për shtetet anëtare që provojnë trysni të shpërpjesëtuar në sistemet e tyre të azilit



dhe pritjes. Në vitin 2023, EUAA-ja siguroi **mbështetje operationale** për 13 shtete anëtare të BE-së në disa fusha të cilat, në varësi të nevojave specifike të secilit vend, mund të përfshijnë mbështetje për të rritur kapacitetin dhe cilësinë në regjistrimin dhe përpunimin e kërkesave në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë; në sistemet kombëtare të pritjes; në procedurën e Dublinit; në vlerësimet e cenueshmërisë dhe në përmirësimin e mbrojtjes për të miturit e pashoqëruar; në përmirësimin e ofritit dhe menaxhimit të informacionit; dhe në fushat e zhvendosjes dhe risistemimit. Vlerësimet e mbështetjes operationale të Agjencisë të kryera në vitin 2023 treguan se mbështetja u ofrua në mënyrë efikase, si dhe çoi në përmirësimin e flukseve të punës dhe rritjen e kapacitetit. Gjithashtu, gjatë gjithë vitit 2023, EUAA-ja vazhdoi të mbështesë dimensionin e jashtëm të CEAS përmes bashkëpunimit të saj me vendet e treta në bazë të udhërrëfyesve dypalësh dhe programeve rajonale të financuara nga BE.

Në maj të vitit 2023, u emërua Oficeri i parë i Agjencisë për të Drejtat Themelore (FRO), i cili filloi të zhvillojë Strategjinë e Agjencisë për të Drejtat Themelore dhe të krijojë një mekanizëm ankesash për t'iu përgjigjur pretendimeve për shkelje të të drejtave themelore në kontekstin e operacioneve të Agjencisë. Gjithashtu u ndërmorën hapa për hartimin e një metodologjie për njësinë e re të monitorimit të Agjencisë. Fokusi do të ishte puna e ngushtë me shtetet anëtare për të monitoruar se si zbatohen në praktikë detyrimet ligjore të legjislacionit *acquis* të BE-së për azilin; për të vlerësuar kapacitetin e shteteve anëtare për menaxhimin e presionit; për të parandaluar mangësitë; për të identifikuar kufizimet ekzistuese; dhe për të ndihmuar shtetet anëtare në adresimin e tyre.

Në vitin 2023, EUAA-ja mbajti presidencën e radhës të **Rrjetit të Agjencive të Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme (JHAAN)**, dhe bashkëpunoi së bashku me agjencitë e tjera në pesë fusha kryesore prioritare:

- Dixhitalizimi, që mbulon çështje që lidhen me përdorimin e inteligjencës artificiale, biometrikës dhe interoperabilitetit;
- Zbatimi i Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së në Agjencitë JHA;
- Ofrimi i informacionit në situata të emigracionit të përzier;
- Siguria kibernetike; dhe
- Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar aktivitetet dhe funksionimin e rrjetit.

Lidhja për në seksionin në raportin kryesor: <https://euaa.europa.eu/asylum-report-2024/section-5-euaa-support-2023>



Vërejtjet përfundimtare

Në vitin 2023, vendet evropiane vazhduan të presin një numër rekord personash në nevojë për mbrojtje, pasi kërkesat për azil u rritën për të dytin vit radhazi. Konflikti, persekutimi, shkeljet e të drejtave të njeriut, fatkeqësitë natyrore dhe ekosistemet në përkeqësim vazhdonin të detyronin miliona njerëz që të largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe disa që të kërkonin mbrojtje në Evropë.

Niveli prej mbi 1,1 milion kërkesash të depozituara në vendet e BE+ në vitin 2023 të kujton shifrat e 2015-2016, vitet e krizës së emigracionit në Evropë. Në të njëjtën kohë, vendet e BE+ shpallën mbi 1,1 milion vendime që u garantonin mbrojtje të përkohshme personave të zhvendosur nga Ukraina, teksa konflikti vazhdon dhe vendi ende përballet me pasojat shkatërruese të pushtimit rus. Një ndryshim i dukshëm midis viteve 2015-2016 dhe 2022-2023 është se gjatë krizës së emigracionit shtimi i numrit të kërkesave erdhi nga disa vende të caktuara, ndërsa aktualisht azilkërkuessit vijnë nga një numër më i madh vendesh, duke bërë kështu të nevojshëm një diversitet më të lartë në udhëzime për të vlerësuar në mënyrë efektive nevojat e mbrojtjes.

Është e qartë se totali i përbashkët i njerëzve që kërkojnë mbrojtje i vendosi sistemet e azilit dhe pritjes në Evropë nën presion ekstrem. Identifikimi i zgjidhjeve të mbrojtjes u arrit në sajë të vullnetit politik për alokimin e burimeve shtesë dhe kombinimit të përpjekjeve dhe ekspertizës nga grupe të shumta interesi në nivel BE-je, kombëtar dhe lokal. Në ndryshim nga periudha 2015-2016, situata e vitit të kaluar nuk është paraqitur si “krizë” në diskursin publik, ndërkohë që po asistohen më shumë persona në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe të përkohshme. Kjo tregon se, pavarësisht kufizimeve në masa të ndryshme lidhur me funksionimin e sistemeve kombëtare të azilit dhe pritjes, vendet evropiane kanë bërë përparim në rritjen e gatishmërisë dhe janë më të mirëpajisura për menaxhimin e flukseve të larta në hyrje të njerëzve që kërkojnë mbrojtje.

Megjithatë, boshllëqet dhe mangësitë ishin gjerësisht të përhapura në sistemet e pritjes, me raportime të shpeshta nga organizatat ndërkombëtare, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, avokatët e popullit dhe organizatat e shoqërisë civile lidhur me kushtet nën standard të jetesës, natyrën e kufizuar të shërbimeve mbështetëse dhe mungesën e strehimit. Autoritetet e azilit kanë raportuar gjithashtu se gjendja shëndetësore e azilkërkuessve që mbërrijnë është gjithnjë e më e keqe, me gjasë si rezultat i udhëtimeve nga më të rrezikshmet që ata ndërmarrin për të arritur në Evropë. Për një përgjigje metodike dhe sistematike ndaj këtyre nevojave shëndetësore nevojiten më shumë burime. Meqenëse është e qartë se presioni do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, vendet e BE+ duhet të programojnë dhe investojnë përkatësisht për rritjen e kapaciteteve të përpunimit dhe për fuqizimin e sistemeve të pritjes, në mënyrë që të ofrojnë kushte dinjitoze pritjeje për njerëzit në nevojë.

Në situatën e përpjekjeve nga vendet e BE+ për të siguruar mbrojtje efektive dhe kufizimeve të raportuara në funksionimin e sistemeve të azilit dhe pritjes, roli i institucioneve gjyqësore në interpretimin e legjislacionit *acquis* të BE-së për azilin dhe në udhëzimin e zbatimit praktik të CEAS ka qenë vendimtar. Si GjDBE-ja, ashtu edhe institucionet gjyqësore kombëtare vazhduan shqyrtimin e legjislacionit, politikave dhe praktikave kombëtare në një numër fushash të lidhura me CEAS-in, duke vendosur një theks të veçantë në aksesin efektiv në territor dhe procedurën e azilit, zbatimin e parimit të *moskthimit*, procedurën e Dublinit, vlerësimin e kërkesave, kushtet e pritjes (duke përfshirë masat mbrojtëse për azilkërkuessit me



nevoja të veçanta) dhe ndalimin. Në përgjigje të kërkesave në rritje, pritet që përpjekjet për të eksternalizuar përpunimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare të mbeten në axhendën politike. Në këtë kontekst, do të jetë thelbësore që gjykatat kombëtare të kryejnë rishikime gjyqësore për të siguruar që azilkërkuesve t'u sigurohen procedura të drejta dhe efikase të azilit.

Në kushtet e një pjese të konsiderueshme të çështjeve të mbetura në pritje të një vendimi në shkallë të dytë, pritet që vendimet e gjykatës të përcaktojnë gjithnjë e më shumë praktikën e ligjshme dhe të ndikojnë në politikën e azilit në vendet e BE+. Për këtë qëllim, është thelbësore të alokohen burime për të avancuar zhvillimin profesional dhe ekspertizën mbi azilin në radhët e gjyqtarëve në nivel kombëtar. Po ashtu, është me shumë rëndësi edhe respektimi i vendimeve të gjykatës nga ana e autoriteteve, me qëllim rritjen e besimit të CEAS-i dhe mbrojtjen e integritetit të tij.

Një temë që ngjalli shumë diskutime në vitin 2023, ashtu si në vitet e mëparshme, ishte sfida e dyfishtë e menaxhimit të kufijve dhe aksesit efektiv në mbrojtje për personat në nevojë. Në vitin 2023, u ndërmorën hapa të rëndësishëm drejt kalibrimin të një sistemi evropian të menaxhimit të integruar të kufijve për të kontrolluar në mënyrë efektive kufijtë e jashtëm tokësorë dhe detarë dhe për të mbrojtur funksionimin e zonës Shengen. Kjo u bë me anë të ndërlikohjes dhe ndërveprimit të sistemeve të informacionit për kufijtë dhe sigurinë, koordinimit më të ngushtë midis agjencive evropiane dhe autoriteteve kombëtare, si dhe bashkëpunimit me vendet e treta. Gjithashtu, një komponent kyç i menaxhimit të integruar evropian të kufijve, siç është përvijuar nga Komisioni Evropian në vitin 2023, është respektimi i plotë i të drejtave themelore. Megjithatë, në disa raste pati raportime të praktikave që pengojnë aksesin efektiv në territor për njerëzit që mund të kenë pasur nevojë për mbrojtje. Është thelbësore që vendet e BE+ të ngrenë dhe të sigurojnë një mekanizma të pavarur për të monitoruar respektimin e të drejtave të njeriut në kufij, siç parashikohet edhe në Paktin për Migracionin dhe Azilin.

Padyshim, marrëveshja politike dhe hapat vijues praktikë të ndërmarrë drejt miratimit të paktit kanë qenë një avancim i madh në evolucionin e CEAS-it. Gjatë evolucionit të tij, CEAS-i i ka nxitur gjithmonë vendet e BE+ të përmirësojnë sistemet e tyre të azilit dhe pritjes, si dhe të rrisin standardet e mbrojtjes. Pakti synon të sigurojë një sistem modern azili që të jetë, faktikisht, kompleks dhe të ofrojë një sërë instrumentesh. Ai synon t'u vijë në ndihmë vendeve që të adresojnë një realitet kompleks në një tablo migracioni të përcaktuar nga parametra të shumëfishtë, të larmishëm dhe shpesh të paparashikueshëm. Meqenëse nuk mund të parashikohen të gjithë skenarët e mundshëm, pakti synon të forcojë zgjidhjet dhe të zgjerojë gamën e mundësive të adresuara nga instrumentet e tij të ndryshme.

Hartimi i legjislacionit të përbashkët, megjithëse i rëndësishëm, përbën vetëm një prej hapave drejt politikës së unifikuar të azilit dhe standardeve të harmonizuara të mbrojtjes. Po aq thelbësor është edhe zbatimi i rregullave në mënyrë konvergjente dhe të harmonizuara. Muajt pas miratimit të paktit do të jenë një periudhë e ngarkuar, por konstruktive, gjatë së cilës vendet, me udhëzimin e Komisionit Evropian dhe mbështetjen e agjencive të BE-së, do të marrin masat e nevojshme për zbatimin praktik të paktit. Në këtë proces dhe më gjerë, EUAA-ja do të vazhdojë të përbëjë një komponent jetik të strukturës evropiane të azilit, duke ofruar mbështetje teknike, operacionale dhe trajnuese për vendet e BE+. Me përforsimin e mandatit të saj, Agjencia do të punojë ngushtësisht me vendet për të monitoruar se si zbatohen në praktikë detyrimet ligjore të legjislacionit *acquis* të BE-së për azilin, për të parandaluar mangësitë, për të identifikuar kufizimet ekzistuese dhe për të ndihmuar vendet në adresimin e tyre.

Raporti për azilin, 2024: Përmbledhje ekzekutive

Si burimi kryesor i informacionit për mbrojtjen ndërkombëtare në Evropë, Raporti për azilin, 2024 ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zhvillimeve kryesore në fushën e azilit në vitin 2023. Përmbledhja ekzekutive është versioni i shkurtuar i raportit kryesor.

Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) mbledh informacione për të gjitha aspektet e Sistemit të Përbashkët Evropian për Azilin. Për këtë qëllim, raporti ravijëzon ndryshimet në politika, praktika dhe legjislacion. Raporti paraqet tendencat lidhur me azilin, treguesit kryesorë për vitin referencë 2023, një pamje të përgjithshme të sistemit të Dublinit i cili përcakton shtetin anëtar përgjegjës për trajtimin e një çështjeje dhe një seksion enkas për azilkërkuesit me nevoja të veçanta, duke përfshirë të miturit e pashoqëruar. Shembujt e jurisprudencës janë paraqitur për të interpretuar legjislacionin evropian dhe kombëtar në kontekstin *acquis* së BE-së për azilin.

Raporti për azilin, 2024 mbështetet në informacione nga një gamë e gjerë burimesh – duke përfshirë perspektivat nga autoritetet kombëtare, institucionet e BE-së, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile dhe bota akademike – për të dhënë një tablo të plotë dhe perspektiva të ndryshme. Raporti, i cili mbulon periudhën 1 janar-31 dhjetor 2023, shërben si referencë për zhvillimet më të fundit në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare në Evropë.